



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 181/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Drita Kabashi, nga fshati Sallagrazhde, Komuna e Suharekës, paraqitur kundër koalicionit PDK-AAK-NISMA, për shkak të shfrytëzimit të pronës private pa autorizim në spotin politik, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 10.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

LEJOHET tërheqja e ankesës të paraqitur nga Drita Kabashi, nga fshati Sallagrazhde, Komuna e Suharekës, Anr. 181/2017, e datës 09.06.2017.

A r s y e t i m

Drita Kabashi, nga fshati Sallagrazhde, Komuna e Suharekës, ka paraqitur ankesë në PZAP kundër koalicionit PDK-AAK-NISMA, për shkak të shfrytëzimit të pronës private pa autorizim në spotin politik, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Me datë 10.06.2017, PZAP-i ka pranuar një shkresë me të cilën Liridon Kabashi ka parashtruar kërkesë për tërheqjen e ankesës me numër Anr.181/2017, të cilën e kishte parashtruar Drita Kabashi nga fshati Sallagrazhde, Komuna e Suharekës.

PZAP-i, ka komunikuar me telefon me parashtruesen e ankesës respektivisht me personin që e ka parashtruar kërkesën për tërheqjen e ankesës Anr.181/2017 te datës 09.06.2017 dhe ka konstatuar se parashtruesja e ankesës me vullnetin e saj e ka tërhequr e ankesën në fjalë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës, në kuptim të nenit 115.1 të LZP – së, PZAP – i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr. 181/2017 më datën 10.06.2017



Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj